




Më datë 01.07.2026

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-Albana Gashi-Drejtores, duke u bazuar në nenin 53 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 26 të Rregullores Nr.145, të datës 03.12.2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale, merr:

V E N D I M

1. Anullohet Konkursi me Nr. 559, i datës 29.04.2026, për pozitën Stomatolog.
2. Anullohet Konkursi me Nr. 563, i datës 29.04.2026, për pozitën Biokimist.
3. Obligohen Njësia e Burimeve Njerëzore dhe Zyrtari për Informim që ta bëjnë publik anulimin e konkurseve në të gjitha mjetet e informimit ku janë publikuar konkursset.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në kuadër të kompetencave ligjore, ka shpallur Konkursin me Nr. 559 të datës 29.04.2026, për pozitën Stomatolog, si dhe Konkursin me Nr. 563 të datës 29.04.2026, për pozitën Biokimist.

Pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit që ndërlidhet me procedurën e rekrutimit për konkurset e lartcekura, është konstatuar se gjatë zhvillimit të procedurës kanë ndodhur gabime teknike dhe administrative, të cilat kanë ndikuar në rregullsinë e procesit të rekrutimit.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale duke u bazuar në nenin 53 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konstaton se ka kompetencë ligjore të korrigjojë dhe të eliminojë parregullsitë procedurale me qëllim të sigurimit të ligjshmërisë, transparencës dhe mbi të gjitha trajtimit të barabartë të të gjithë kandidatëve, andaj duke u bazuar në atë që u cek më lartë vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e publikimit të tij, në Komisionin për Ankese brenda institucionit.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Drejtores së Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtorit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe Arkivit.

